



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 6

Tiranë – E mërkurë, 28 janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 1/2015, datë 19.1.2015	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 91/2014 “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar më thellë fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore” 117
Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 2/2015, datë 19.1.2015	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 81/2014..... 117
Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 3/2015, datë 19.1.2015	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 92/2014 “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore” 118
Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 4/2015, datë 19.1.2015	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 82/2014..... 118
Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 5/2015, datë 19.1.2015	Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit..... 118
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 52, datë 21.1.2015	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015..... 122
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 19.1.2015	Me objekt interpretimin e vendimit nr. 47, datë 11.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me kërkuar Afërdita Papamihali..... 124

Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 14, datë 22.1.2015	Për miratimin e programit model të transparencës.....	126
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 402, datë 21.1.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash-Morinë”.....	136



VENDIM
Nr. 1/2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 91/2014 “PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE, SI DHE PËR TË NJOHUR DHE VERIFIKUAR MË THELLË FENOMENIN E NDËRHYRJES DHE TË BLOKIMIT PËR DISA DITË TË SISTEMEVE ELEKTRONIKE TATIMORE”

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 91/2014 “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar më thellë fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”, në pikën “I” plotësohet përbërja e këtij komisioni si më poshtë:

- | | |
|--------------------|--------------|
| 1. Arben Ristani | Kryetar (PD) |
| 2. Jorida Tabaku | Anëtare (PD) |
| 3. Florion Mima | Anëtar (PD) |
| 4. Helidon Bushati | Anëtar (PD) |
| 5. Ylli Shehu | Anëtar (PR) |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 19.1.2015

VENDIM
Nr. 2/2015

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE, SI DHE PËR TË NJOHUR DHE VERIFIKUAR NË THELLËSI FENOMENIN E NDËRHYRJES DHE BLOKIMIT PËR DISA DITË TË SISTEMEVE ELEKTRONIKE TATIMORE, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 81/2014

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 81/2014, zgjatet për një periudhë 2-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 19.1.2015



VENDIM
Nr. 3/2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 92/2014 “PËR
MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT HETIMOR TË
KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN E
LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË
DETYRË NË ADMINISTRATËN
SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO
SHOQËRITË TREGTARE
SHTETËRORE”

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 92/2014 “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore”, në pikën “I” plotësohet përbërja e këtij komisioni si më poshtë:

- | | |
|------------------|--------------|
| 1. Genc Pollo | Kryetar (PD) |
| 2. Voltana Ademi | Anëtare (PD) |
| 3. Keltis Kruja | Anëtar (PD) |
| 4. Alban Zeneli | Anëtar (PD) |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 19.1.2015

VENDIM
Nr. 4/2015

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR
VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË
EMËRIMEVE NË DETYRË NË
ADMINISTRATËN SHTETËRORE,
ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË
TREGTARE SHTETËRORE, NGRITUR
ME VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 82/2014

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 82/2014, zgjatet për një periudhë 2-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 19.1.2015

VENDIM
Nr. 5/2015

PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve, të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisioneve të Përhershme të Kuvendit dhe e kryesive të tyre është si më poshtë:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

1	Fatmir Xhafaj	Kryetar	PS
2	Oerd Bylykbashi	Zëvendëskryetar	PD
3	Armando Subashi	anëtar	PS
4	Vasilika Hysi	anëtare	PS
5	Bashkim Fino	anëtar	PS
6	Pandeli Majko	anëtar	PS
7	Blendi Klosi	anëtar	PS
8	Dashamir Peza	anëtar	PS
9	Ulsi Manja	anëtar	PS
10	Vexhi Muçmataj	anëtar	PS
11	Tom Doshi	anëtar	PS
12	Petrit Vasili	anëtar	LSI
13	Silva Caka	anëtare	LSI
14	Eduart Halimi	anëtar	PD
15	Arben Ristani	anëtar	PD
16	Gent Strazimiri	anëtar	PD
17	Mhill Fufi	anëtar	PR
18		anëtar	
19		anëtar	
20		anëtar	

Komisioni për Integrimin European

1	Majlinda Bregu	Kryetare	PD
2	Taulant Balla	Zëvendëskryetar	PS
3	Gramoz Ruçi	anëtar	PS
4	Esmeralda Shkja	anëtare	PS
5	Ilir Xhakolli	anëtar	PS
6	Sadri Abazi	anëtar	PS
7	Bujar Derveni	anëtar	LSI
8	Kejdi Mehmetaj	anëtar	LSI
9	Arben Imami	anëtar	PD
10	Gerti Bogdani	anëtar	PD
11	Edi Paloka	anëtar	PD

Komisioni për Politikën e Jashtme

1	Arta Dade	Kryetare	PS
2	Aldo Bumçi	Zëvendëskryetar	PD
3	Namik Dokle	anëtar	PS
4	Valentina Leskaj	anëtare	PS
5	Ben Blushi	anëtar	PS
6	Vangjel Dule	anëtar	I pavarur
7	Luljeta Arapi	anëtare	PS
8	Anila Agalliu	anëtare	PS
9	Përparim Spahiu	anëtar	LSI
10	Jozefina Topalli	anëtare	PD
11	Eduart Selami	anëtar	PD
12	Kastriot Islami	anëtar	PD
13		anëtar	
14		anëtar	

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

1	Erion Braçe	Kryetar	PS
2	Ridvan Bode	Zëvendës kryetar	PD
3	Anastas Angjeli	anëtar	PS
4	Majlinda Bufi	anëtare	PS
5	Andrea Marto	anëtar	PS
6	Blerina Gjylameti	anëtare	PS
7	Ervin Koçi	anëtar	PS
8	Evis Kushi	anëtare	PS
9	Ervin Bushati	anëtar	PS
10	Koço Kokëdhima	anëtar	PS
11	Gjovalin Kadeli	anëtar	LSI
12	Gledion Rehovica	anëtar	LSI
13	Luan Duzha	anëtar	LSI
14	Florion Mima	anëtar	PD
15	Sherefedin Shehu	anëtar	PD
16	Edmond Spaho	anëtar	PD
17	Liliana Elmazi	anëtare	PD
18	Dashamir Shehi	anëtar	PD
19	Jorida Tabaku	anëtare	PD
20	Igli Cara	anëtar	PD

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

1	Spartak Braho	Kryetar	LSI
2	Flamur Noka	Zëvendëskryetar	PD
3	Pirro Lutaj	anëtar	PS
4	Arben Çuko	anëtar	PS
5	Arben Ndoka	anëtar	PS
6	Anduel Xhindi	anëtar	PS
7	Armando Prenga	anëtar	PS
8	Paulin Sterkaj	anëtar	PS
9	Pjerin Ndreu	anëtar	PS
10	Xhemal Qefalia	anëtar	PS
11	Rakip Suli	anëtar	PS
12	Luan Rama	anëtar	PS
13	Shkëlqim Selami	anëtar	LSI
14	Mesila Doda	anëtare	PD
15	Ardian Turku	anëtar	PD
16	Astrit Patozi	anëtar	PD
17	Keltis Kruja	anëtar	PD
18	Alban Zeneli	anëtar	PDIU
19		anëtar	
20		anëtar	

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

1	Eduart Shalsi	Kryetar	PS
2	Genc Ruli	Zëvendëskryetar	PD
3	Artan Gaçi	anëtar	PS
4	Besnik Baraj	anëtar	PS
5	Namik Kopliku	anëtar	PS
6	Mira Shehu	anëtare	PS
7	Gentian Bejko	anëtar	PS
8	Artur Bushi	anëtar	PS
9	Parid Cara	anëtar	PS
10	Vladimir Kosta	anëtar	PS
11	Monika Kryemadhi	anëtare	LSI



12	Robert Bitri	anëtar	LSI
13	Piro Kapurani	anëtar	LSI
14	Besnik Dusha	anëtar	PR
15	Helidon Bushati	anëtar	PD
16	Voltana Ademi	anëtare	PD
17	Gjergji Papa	anëtar	PD
18	Kozma Dashi	anëtar	PD
19		anëtar	
20		anëtar	

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

1	Albana Vokshi	Kryetare	PD
2	Klodiana Spahiu	Zëvendëskryetare	PS
3	Ilir Pendavinji	anëtar	PS
4	Olta Xhaçka	anëtare	PS
5	Eduart Bejko	anëtar	PS
6	Ylli Ziçishti	anëtar	PS
7	Erjeta Alhysa	anëtare	PS
8	Mark Frroku	anëtar	PS
9	Vangjel Tavo	anëtar	LSI
10	Bujar Kllogjeri	anëtar	LSI
11	Halim Kosova	anëtar	PD
12	Roland Keta	anëtar	PD
13	Albina Deda	anëtare	PD
14	Bedri Mihaj	anëtar	PD
15		anëtar	

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

1	Genc Pollo	Kryetar	PD
2	Alfred Peza	Zëvendëskryetar	PS
3	Musa Ulqini	anëtar	PS
4	Adelina Rista	anëtare	PS
5	Dashamir Kamberi	anëtar	PS
6	Enkeleda Shkreli	anëtare	PS
7	Fidel Ylli	anëtar	PS
8	Mimoza Hafizi	anëtare	PS
9	Fatmir Toçi	anëtar	PS
10	Miranda Rira	anëtare	LSI
11	Agron Çela	anëtar	LSI
12	Myqerem Tafaj	anëtar	PD
13	Bedri Hoxha	anëtar	PR
14	Luçiano Boçi	anëtar	PD
15	Astrit Veliaj	anëtar	PD
16	Eleina Qirici	anëtare	PD
17	Gjovalin Bzheta	anëtar	PDIU

II. Vendimet nr. 48/2013, nr. 55/2013, nr. 60/2013, nr. 68/2013, nr. 70/2013, nr. 10/2014, nr. 15/2014, nr. 18/2014, nr. 23/2014, nr. 50/2014, nr. 76/2014 dhe nr. 72/2014 shfuqizohen.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 19.1.2015

**VENDIM****Nr. 52, datë 21.1.2015****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË
PËRFITIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2015 për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit, të përdoret për:

a) investimet për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve për të garantuar furnizimin e qëndrueshëm të tregut;

b) përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe të mbrojtjes së bimëve;

c) prodhimin e perimeve në ambiente të mbrojtura për zbutjen e sezonalitetit të furnizimit të tregut;

ç) mbarështimin e blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës;

d) furnizimin e qëndrueshëm të tregut dhe rritjen e të ardhurave financiare për familjet e zonave rurale;

dh) nxitjen e kreditimit bankar dhe investimeve në sektorin e përpunimit, ruajtjes dhe marketingut të produkteve bujqësore, blegtorale, shpendëve, akuakulturës, mjaltit dhe bimëve medicinale;

e) rritjen e mundësisë së fermerëve për mjete të mekanizuara dhe lëndëve djegëse për ngrohjen e ambienteve të mbrojtura;

ë) nxitjen e kooperimit dhe organizimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

2. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, sipas rajonizimit të hartës

bujqësore e cila miratohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në shkallë vendi, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Mbështetje për përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe mbrojtjes së bimëve, si:

i) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së vreshtave me fidanë të kultivarëve autoktonë, në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë/ha dhe me fidanë të kultivarëve të tjerë, në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha;

ii) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së mollëve, dardhave, kumbullave, qershive, pjeshkëve, nektarinave, fiqve, ftonjve, shegëve, kivit, luleshtrydhes dhe agrumeve, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha;

iii) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së arrave, lajthive dhe bajameve, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha për format intensive dhe ekstensive të kultivimit;

iv) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të bimëve medicinale të kultivuara, si: lavanda, timus, rigon, gjethe qumështore, rozmarinë, mullagë e bardhë, mullagë e zezë, valeriane, mollë e egër, tërfili i kuq, bar blete, lule kalendule, lule dielli (për petale), hithër, helichrysum italicum dhe kokoçeli (lule ciani), në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;

v) përmirësimi i teknikave të ujitjes nëpërmjet mbështetjes financiare të instalimit të ujitjes me pika, në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume, arvore dhe shegë (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), kundrejt faturës tatimore, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, por financimi të bëhet për jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha;

vi) mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi i mizës së ullirit në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit, në vlerën jo më shumë se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/ha;

vii) instalimi i sistemit të ngrohjes me biomasë (pellete), në serat me ngrohje qendrore, në vlerën jo më shumë se 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë/dynymi.

Sipërfajja e mbjellë me kulturat e përshkruara sipas masave të përcaktuara në nënndarjet i-iv, të shkronjës “a”, të pikës 2, duhet të jetë jo më e vogël se 0.2 ha dhe jo më e madhe se 10 ha.



b) Mbarështimi i blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës:

i) në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë dele dhe/ose dhi të matrikulluara për fermat të cilat mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 (treqind) krerë;

ii) në vlerën 1 000 (një mijë) lekë/koshere bletë për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere bletë;

iii) mbështetja e sektorit të akuakulturës, në masën 25% të vlerës së rasantit, por jo më shumë se 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë/fermë dhe/ose 25% të vlerës së ushqimeve për peshkun nën kultivim, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë/fermë, vërtetuar me faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganimi.

c) Furnizimi i qëndrueshëm i tregut dhe rritja e të ardhurave financiare për familjet e zonave rurale për:

i) mbështetje për dorëzimin e prodhimit të frutave dhe perimeve në pikat e grumbullimit ose përpunimit, në masën 15% të vlerës së mallit të shitur, të vërtetuar me faturë tatimore. Sasia e dorëzimit është:

- për jo më pak se 30 kv dhe jo më shumë se 300 kv për frutat;

- për jo më pak se 50 kv dhe jo më shumë se 400 kv për perimet;

- për jo më shumë se 400 kv për fasulen pllaqi.

ii) mbështetje, në vlerën 10 (dhjetë) lekë/litri qumësht, për fermat blegtorale që dorëzojnë jo më pak se 1 500 (një mijë e pesëqind) litra qumësht në muaj, por jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) litra qumësht në muaj, dhe mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara, por financimi të bëhet për jo më shumë se 80 (tetëdhjetë) krerë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruara në organet tatimore;

iii) mbështetje për dorëzimin e prodhimit të midhjeve në qendrat e grumbullimit dhe/përpunimit, në vlerën 10 (dhjetë) lekë/kg të dorëzuar (të shitur) e të vërtetuar me faturë tatimore, por financimi të bëhet për jo më pak se 200 (dyqind) kv dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) kv në vit.

ç) Nxitja e investimeve dhe kreditimit bankar në sektorin bujqësisë, blegtorisë, shpendëve, bletarisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale, si:

i) mbështetja, përmes subvencionit, në masën

70% të normës së interesit, për 7 (shtatë) vite radhazi, për kreditë deri në 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

- Ndërtimin e objekteve që shërbejnë për mbarështimin e kafshëve, shpendëve dhe akuakulturës;

- Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës, shpendëve dhe bimëve medicinale;

- Mekanizimin e bujqësisë, blegtorisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale.

ii) mbështetja e investimeve deri në 50% të vlerës së projektit, kundrejt faturës tatimore përfshirë vlerën e tatimit, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për një subjekt, për:

- ngritje dhe/ose rikonstrukcion ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës, shpendëve dhe bimëve medicinale;

- ngritje dhe/ose rikonstrukcion të ambienteve për mbarështim të kafshëve, shpendëve, midhjes dhe peshkut;

- linja për standardizimin (paketim, mbushje, konservim, ambalazhim) tharje dhe/ose përpunim, si dhe mjete të specializuara transporti të prodhimeve bujqësore, blegtorale, mjalitit, bimëve medicinale, produkteve të akuakulturës;

- mbështetje për energjinë e rinovueshme;

- hapje lerash.

iii) ndërtim të serave për kultivimin e perimeve, prodhim fidanësh dhe produkteve të tjera bujqësore, në masën 60% të vlerës së investimit përfshirë vlerën e tatimit, por jo më shumë se 1 200 000 (një milionë e dyqind mijë) lekë për dynym, për sera me sipërfaqe minimumi 2 dynymë dhe jo më shumë se 2 ha;

iv) Mbështetja e investimeve deri në masën 60% të vlerës për traktorë dhe/ose agregate të tjera bujqësore për manovrim në nivel ferme, përfshirë vlerën e tatimit.

3. Përfitues për masat e mbështetjes dhe masën e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural do të jenë personat fizikë, personat juridikë dhe SHBB-të.

4. Nga ky fond do të përdoret vlera prej 154 700 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e shtatëqind mijë) lekësh për bashkëfinancim me projektin e IPA-s 2011, “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.



Përdorimi i këtyre fondeve do të realizohet sipas marrëveshjes operacionale të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, AZHBR-së dhe GIZ.

5. Nga ky fond të përdoret vlera prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh për aktivitete informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015.

6. Financimi i masës mbështetëse për prodhimin në serra me ngrohje qendrore, skemë e vitit 2014, të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2015, me fondet e caktuara për vitin përkatës buxhetor, por sipas masës dhe kushteve të përfitimit, të përcaktuar për vitin 2014.

7. Projektet e vlerësuara dhe të verifikuara ose të kontraktuara gjatë vitit 2014, të cilat janë shpallur fituese dhe nuk janë financuar për shkak të shkurtimeve të fondeve gjatë vitit buxhetor 2014, të paguhet me fondet e vitit 2015, brenda tremujorit të parë të vitit 2015, sipas masës dhe kushteve të përfitimit, të përcaktuara për vitin 2014, por jo më shumë se fondi i alokuar prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1, datë 19.1.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 18.12.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 64/31 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë

SUBJEKT I INTERESUAR: Afërdita Papamihali

OBJEKTI: Interpretimi i vendimit nr. 47, datë 11.11.2013 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me kërkuar Afërdita Papamihali.

BAZA LIGJORE: Nenet 28, 29 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 300, datë 10.11.2009, ka vendosur: “*Deklarimin fajtorë të të pandeburës Afërdita Papamihali, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e saj me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe 500 000 lekë gjobë... Në bazë të nenit 35/2 të KP-së, heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandeburën Afërdita Papamihali, për një periudhë prej 3 vjetësh*”.

2. Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 123, datë 13.9.2010, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 300, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në lidhje me të pandeburit S.J., A. M., L. M. dhe P. M. Prishjen e këtij vendimi në lidhje me të pandeburit G.M., A.Sh. dhe Afërdita Papamihali dhe pushimin e çështjes ndaj tyre, pasi nuk vërtetohen elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar, atë të parashikuar nga neni 248 i KP-së.*” Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastrë.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013, ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 123, datë 13.9.2010 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastrë për të gjykuar G.M., A.Sh. dhe Afërdita Papamihali, duke*



lënë në fuqi për këta të gjykuar vendimin nr. 300, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë...”

4. Shtetasja Afërdita Papamihali i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të aplikimit të dy dënimeve kryesore ndaj saj.

5. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 47, datë 11.11.2013, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-387 (33), datë 31.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.*”

6. Gjatë rigjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, për arsye se vendimet e dhëna në përfundim të gjykimit u përkasin dhe kanë efekt edhe ndaj disa të pandehurve të tjerë, organi i prokurorisë ka kërkuar pezullimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për interpretimin e vendimit të saj nr. 47, datë 11.11.2013.

II

7. **Kërkuesi, Prokuroria e Përgjithshme**, paraqet këto shkaqe në mbështetje të pretendimit për interpretimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese:

7.1 Ndërkohë që në pjesën arsyetuese të vendimit bëhet fjalë për shkelje të standardeve të gjykimit vetëm për kërkuesen Afërdita Papamihali, në mënyrën si është disponuar në dispozitivin e vendimit krijohen dyshime mbi atë çka realisht ka vendosur Gjykata Kushtetuese, në lidhje me dy momente:

7.1.1 *Në aspektin e subjekteve.* A shtrihet vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese vetëm për kërkuesen Afërdita Papamihali, apo edhe për subjektet e tjera ndaj të cilëve është proceduar?

7.1.2 *Në aspektin lëndor.* A është shfuqizuar vendimi në tërësinë e tij (*deklarimi fajtor, dënimi me burgim, dënimi me gjobë, dënimi plotësues*) apo është prishur vetëm pjesa e dënimit me gjobë në aplikimin e të cilës është konstatuar shkelje?

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

8. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se për të ushtruar kompetencën e parashikuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për interpretimin, plotësimin ose ndreqjen e gabimeve në vendimin saj, ajo mund të vihet në lëvizje vetëm nga palët pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 166, datë 20.06.2007 dhe nr. 23, datë 23.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata vëren se kërkuesi, Prokuroria e Përgjithshme, ka qenë palë si në procesin penal të zhvilluar ndaj shtetasës Afërdita Papamihali, ashtu edhe në procesin e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, në përfundim të të cilit është dhënë vendimi nr. 47, datë 11.11.2013 që kërkohet të interpretohet. Në këto kushte ky subjekt legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. Për themelin e pretendimeve

10. Gjykata vëren se, sipas nenit 80/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, edhe pse nuk mund të anulohet ose ndryshojë vendimin e saj, ajo ka të drejtë ta interpretojë atë në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen e këtij vendimi.

11. Në rastin konkret Gjykata është vënë në lëvizje për interpretimin e vendimit të saj nr. 47, datë 11.11.2013, me të cilin është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë. Edhe pse vendimi i shfuqizuar i Gjykatës së Lartë ka pasur efekt dhe ka sjellë pasoja edhe për dy të pandehur të tjerë në atë proces penal, në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese është pranuar se në kuadrin e respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, për sa i përket të gjykuarës Afërdita Papamihali, e cila e ka vënë në lëvizje këtë Gjykatë në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Pavarësisht se në dispozitivin e vendimit që kërkohet të interpretohet nuk është specifikuar



qartësisht se për cilin të gjykuar sjell pasoja ky vendim, ky konkluzion arrihet lehtësisht nëse vendimi lexohet në tërësinë e tij, duke e konsideruar atë si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre.

12. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se dispozitivi i vendimit nr. 47, datë 11.11.2013, që është kërkuar të interpretohet, ka efekt vetëm për të gjykuarën Afërdita Papamihali.

13. Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuarit, i cili lidhet me interpretimin e faktit nëse vendimi nr. 47, datë 11.11.2013 e ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë në tërësinë e tij, apo është shfuqizuar vetëm pjesa e dënimit me gjobë në aplikimin e të cilës është konstatuar shkelja, Gjykata vlerëson se nuk ndodhet para rastit të parashikuar në nenin 80, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 11.11.2013 i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vendimin nr. 00-2013-387 (33), datë 31.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, interpretohet se ka efekt vetëm për të gjykuarën Afërdita Papamihali.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar) Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

URDHËR

Nr. 14, datë 22.1.2015

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS

Në mbështetje të neneve 6 dhe 8, pika 2 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

URDHËRON:

1. Miratimin e programit model të transparencës, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e standardit për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur.

3. Miratimin e modelit të kërkesës dhe përgjigjes “Për dhënie të informacionit/dokumentacionit” që rekomandohet të përdoret nga autoritetet publike, sipas lidhjes nr. 3, bashkëlidhur.

4. Miratimin e akteve shkresore që rekomandohen të përdoren nga autoritetet publike, për vendimmarrjet, sipas lidhjes nr. 4, bashkëlidhur:

a) “Për refuzimin e formës së kërkuar” (neni 14/4);

b) “Për zgjatjen e afatit” (neni 15/3);

c) “Për rishikimin e dokumenteve të klasifikuara dhe shtyrjen e afatit” (neni 17/5).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

LIDHJA NR. 1

PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR (emërtimi i autoritetit publik)

I. HYRJJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës për ... (vendoset emërtimi i autoritetit publik). Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës autoriteti publik (këtej e



tutje AP) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. AP-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AP-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.\(..\).al](http://www.(..).al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AP-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AP -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave. AP-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AP-së dhe përkatësisht: Ligji nr. ...datë..., ligji nr. ...datë....

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).

6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ... (emërtimi i AP-së) vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www...\(..\).al](http://www...(..).al) dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;



- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të

dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;

- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

- AP-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË

(vendoset emërtimi i autoritetit publik)

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	<u>p.sh:</u> Struktura organizative vendoset e plotë ose në link.	<u>p.sh:</u> 1)Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare, 2)Referojuni pikës 3 të nenit 7, ose 3) Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	<u>p.sh:</u> Referohet menuja përkatëse në faqe zyrtare.	<u>p.sh:</u> Koordinator; titullari ose nëpunësi i deleguar prej tij.
Akte ndërkombëtare ligje; akte nënligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b				



Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g				
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç				
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d				
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh				
Buxheti	Neni 7/1/e				
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë				
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f				
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/1/h				
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji nr. 119/2014	Neni 7/1/i				
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k				
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l				



V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AP-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [[www. \(vendos adresën e plotë të internetit\)](#)] dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

LIDHJA NR. 2

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. rendor (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
1		(Përmban edhe përmbledhje të kërkesës)	(Përmban edhe përmbledhje të përgjigjes)		
2					
3					

Shënim

Regjistri përditësohet çdo tre muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndihmon kërkuuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.



LIDHJA Nr. 3 (kërkesa)

KËRKESË PËR INFORMACION

Emër mbiemër: Z./Znj _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/201__ Nënshkrimi:
--------------------------------------	---	---

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni/dokumentacioni: _____

Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.		

- Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

- Drejtoni kërkesën tuaj, koordinatori për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

- Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**LIDHJA NR. 3 (përgjigja)****REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/201__

Lënda: Jepet informacioni/dokumentacioni i kërkuar.**Kërkuesit:** Z/Znj. _____**Adresa:**

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë (autoriteti publik), në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor ____, datë ____/____/201__ (sipas rregjistrimit përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve).

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni (përshkrim i akteve/informacioneve /dokumentacionit që kërkohet).

1. _____
2. _____
3. _____

AUTORITETI PUBLIK**Shënim:**

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.



LIDHJA NR. 4/a

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/201__

Lënda: Mbi refuzimin e formës së kërkuar të informacionit/dokumentacionit.**Kërkuesit:** **Z/Znj.** _____**Adresa:**

Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se (arsyetohet pse autoriteti nuk *disponon..(p.sh) të tilla mjete/ aparate/ pajisje që bëjnë të mundur dhënien e dokumentacionit në formatin e kërkuar*), ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar.

Ndaj refuzimit të kërkesës tuaj, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 24/1,2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

AUTORITETI PUBLIK**Shënim:**

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.



LIDHJA NR. 4/b

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/ 201__

Lënda: Mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes.**Kërkuesit:** Z/Znj. _____**Adresa:**

Në zbatim të pikës 3 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se (evidentoni në përputhje me parashikimet në gërmat “a”, “b”, “c” të nenit 15/3), vendoset për zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes me 5 ditë pune.

Ndaj mosnjoftimit të zgjatjes së afatit të shqyrtimit, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 24/1/2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

AUTORITETI PUBLIK**Shënim:**

Ky akt zyrtar i njoftohet menjëherë kërkuesit.

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.



LIDHJA NR. 4/c



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më __/__/201__

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ju njoftojmë se ka nisur procedura për rishikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në përputhje me ligjin nr.8457, datë 11/02/1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar.

Në këtë rast, afati për vlerësimin e dhënies së informacionit shtyhet (deri në 30 ditë pune).

AUTORITETI PUBLIK

Shënim:

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.

**KËRKESË****Nr. 402, datë 21.1.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash-Morinë” (shtesat për arë, truall dhe objekte ndërtimi).

“Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit: arë, truall dhe objekt.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 26 387 209 (njëzet e gjashtë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntë) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Autoriteti Rrugor Shqiptar

Sektori i shpronësimeve

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT
RRUGOR KALIMASH-MORINË (OBJEKTE NDËRTIMI)**

Nr.	Pronari			ZONA KADAST.	Nr. i pasurisë	Objekte		
	Emri	Atësia	Mbiemri			Vlera në lekë sipas preventivit	Lloji i pasurisë	Shënime ZVRPP
1	Hajdin	Dan	Istrefi	1453	192/11	2199068	Shtëpi Banimi	Konfirmuar nga ZRPP
2	Sulejman	Dan	Istrefi	1453	192/5	2039220	Shtëpi Banimi	Konfirmuar nga ZRPP
3	Man	Istref	Istrefi	1453	192/6+192/10	5174208	Shtëpi Banimi	Konfirmuar nga ZRPP
4	Petrit	Rasim	Oruçi	1453	211/2	1501993	Shtëpi Banimi	Konfirmuar nga ZRPP
5	Ylber		Voka	1453		2030118	Shtëpi Banimi	Konfirmuar nga ZRPP
6	Qemal	Sinan	Mehmetaj	1453	188/2	4357838	Shtëpi Banimi	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				17302445		



PASURITË QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT "KALIMASH-MORINË"(SHITESAT)

Lloji i pasurisë së paluajtshme: arë, truall

Nr.	Pronari			Z. K	Nr. Pas.	Truall			Arë			Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		
1	FATMIR	HAMDI	SHEHU	3425	106/10				11128	182	2025296	2025296	Konfirmuar nga ZVRPP
2	ILMI	AVDI	SHEHU	3425	96/2/1				3964	182	721448	721448	Konfirmuar nga ZVRPP
3	MUS	MUSTAF	SHEHU	3425	96/1				10277	182	1870414	1870414	Konfirmuar nga ZVRPP
4	FADIL	MUSTAF	SHEHU	3425	96/3/1				8316	182	1513512	1513512	Konfirmuar nga ZVRPP
5	SOKOL	FETAH	SHEHU	3425	96/4/1				8136	182	1480752	1480752	Konfirmuar nga ZVRPP
6	MUSTAF	MUS	SHEHU	3425	97/1/2				5062	182	921284	921284	Konfirmuar nga ZVRPP
7	SELAM	FAIK	SHEHU	3425	97/1/3				1411	182	256802	256802	Konfirmuar nga ZVRPP
8	DASHMIR	ZELFI	TODAJ	2208	131/1				686	186	127596	127596	Konfirmuar nga ZVRPP
9	HAMDI	AJET	ORUCI	1543	165/7	830	202	167660					Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI					830		167660	48980		8917104	9084764	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 175 lekë